



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 7/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët, Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partija Kosovskih Srba, dega Lepasaviq, paraqitur kundër Milan M. Kostic kandidat për deputet nga Lista Serpska, për shkak të keqpërdorimit të fëmijëve për promocion politik dhe fushatë zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 16.09.2019, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa Anr.7/2019 e datës 13.09.2019 e subjektit politik Partija Kosovskih Srba (PKS), dega Lepasaviq.

Arsyetim

PZAP-i, me datë 13.09.2019, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Partija Kosovskih Srba dega Lepasaviq, me të cilin thekson se kandidati për deputet nga Lista Srpska Milan M. Kostic në mënyrë më brutale ka keqpërdorur fëmijët për promocione politike dhe fushatë zgjedhore, ku takimin e tij me fëmijët e ka fotografuar dhe e ka shpërndarë në rrjetin e tij facebook me mesazhin e caktuar politik dhe duke theksuar se në vizitën tek fëmijët ishte si kandidat për deputet. Gjithashtu parashtruesi i ankesës cek se kandidati Milan M. Kostic në tubimet publike madhëron dhe promovon karakterin dhe veprën e personit të dyshuar për pjesëmarrje në vepra të rënda kriminale dhe në këtë mënyrë dërgon mesazhin e drejtpërdrejt se përzihet në punën e prokurorisë dhe policisë në mënyrë të pashembullt dhe jo ligjore.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi fotografimin me pamje nga faqja zyrtare të facebookut të Milan M. Kostic si dhe foton e kandidatit për deputet Milan M. Kostic për të cilat pretendohet në ankesë.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Sipas Nenit 33 dhe 44 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullës Zgjedhore Nr. 11/2013, *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët* dhe Rregulla Zgjedhore Nr. 13/2013 *Fushata e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike*, përcaktojnë aktivitetet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ku ndalojnë veprimet e subjekteve politike, mbështetësve të tyre ose kandidatët e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Periudha për fillimin e fushatës zgjedhore e përcaktuar nga KQZ-ja, për Zgjedhjet Parlamentare 2019 fillon nga data 25.09.2019 dhe zgjat deri më datën 04.10.2019, andaj duke u bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore, me të cilën përcaktohen veprimet e ndaluara të subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore si dhe duke pasur parasysh se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nga pala ankuese janë zhvilluar para datës zyrtare të caktuar për fushatë zgjedhore, Paneli konstaton se ankesa në fjalë është e palejuar ngase as me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme e as me Rregullat Zgjedhore nuk është paraparë sanksionimi apo marrja e masave tjera ligjore për këtë periudhë të para fushatës zgjedhore.

Prandaj duke u bazuar në arsyet e lartpërmendura dhe në dispozitat e nenit 33 dhe nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 7/2019 më datën 16.09.2019.

**Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.